



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 259/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ymer Hoxha kryesues, Muharrem Shala dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK) me seli në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI) me seli në Ferizaj, për shkak të manipulimit të nënshkrimeve për themelimin e subjektit politik PAI, në seancën e panelit të mbajtur me 17.11.2010, mori këtë:

V E N D I M

Ankesa refuzohet si e pabazuar

A R S Y E T I M I

Subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK) me seli në Ferizaj, ka parashtruar një ankesë më të cilën pretendon se subjektit politik Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI) me seli në Ferizaj, ka manipuluar nënshkrimet e përkrahësve për themelimin e këtij subjekti politik, sipas parashtruesit të ankesës, nënshkrimet e dy persona të cilët gjenden në listën e subjektit politik PAI, gjëja që kanë nënshkruar këtë përkrahje, këta persona janë: Skender Limani dhe Zenel Limani, që të dytë nga fshati Gadime e Ulët komuna e Lipjanit, këta persona përveç që nuk e kanë aftësinë mendore, nuk dinë as shkrim e lexim.

F A K T E T

Më 02 Nëntor 2010, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka pranuar një ankesë nga Subjektit politik PDAK, me pretendim se subjekti politik PAI, ka manipuluar më nënshkrimet të përkrahësve për themelimin e këtij subjekti politik. Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur as një provë apo dëshmi ankesës.

PZAP-i më datë 03.11.2010, ka kërkuar nga Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) pranë Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), aplikacionin lidhur më regjistrimin e subjektit politik PAI, si dhe të gjitha shkresat që kanë pasur pas regjistrimit të këtij subjekti politik.

PZAP-i, është njoftuar nga ZRPPC-ja, KQZ-ja, më datë 09.11.2010. Në shkresën e ZRPPC- KQZ-së konstatohet se faktet e paraqitura në ankesë në afatin për shqyrtim publik, janë të paqëndrueshme për këto arsye:

- Nënshkrimet në listat e përkrahësve të iniciativës për regjistrimin e PAI, nuk janë jovalide, sepse janë verifikuar nga ZRPPC-ja, dhe është plotësuar numri i mjaftueshëm i kërkuar në bazë të nenit 12.3 germa (j) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe lokale (LZP) dhe nenit 3.1 germa (d) të rregullës zgjedhore Nr. 01/ 2008, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- Manipulimin i personave me të meta mendore për të vënë nënshkrime në listat e përkrahësve me emrat e përmendur si: Skender dhe Zenel Limani nga Gadimja e Ulët komuna e Lipjanit, nuk kanë mundur të vërtetohen, sepse nuk ekziston ndonjë dokumentacion që e dëshmon paaftësinë mendore të këtyre personave.

ANALIZË

Juridiksioni i PZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP*, Ligji Nr.03/L – 256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L- 073 dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* Ligji Nr. 03/L- 072

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Neni 3 paragrafi 6 pika c, e Rregullave dhe Proceduarve të PZAP-it përcakton:

Neni 3.6 (c) hollësi rreth çfarë do dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rast kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3 paragrafi 6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ngase parashtuesi i ankesës nuk ka paraqitur asnjë dëshmitar dhe nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 259/2010 më datën 17.11.2010.

